

**VENDIM**  
**Nr. 831, datë 30.12.2025**

**PËR MIRATIMIN E KODIT TË ETIKËS NË SHKENCË DHE NË KËRKIM SHKENCOR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 1, të nenit 30, të ligjit nr. 109/2024, “Për shkencën dhe kërkimin shkencor në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Arsimit, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Miratimin e Kodit të Etikës në Shkencë dhe në Kërkim Shkencor, që zbatohet në zonën evropiane të kërkimit, në përputhje me Kodin Evropian të Sjelljes për Integritet në Kërkimin Shkencor, i cili rregullon normat e etikës në shkencë dhe në kërkim shkencor, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Ngarkohen ministria përgjegjëse për çështjet e shkencës dhe të kërkimit shkencor, subjektet publike dhe jopublike të kërkimit shkencor dhe punonjësit kërkimorë-shkencorë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTËR**  
**Edi Rama**

**KODI I ETIKËS NË SHKENCË DHE NË KËRKIM SHKENCOR**

**KREU I**  
**DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**

**Neni 1**  
**Objekti**

Objekti është përcaktimi i rregullave, normave, kritereve dhe procedurave të zbatimit të etikës në shkencë dhe në kërkim shkencor, bazuar në Kodin Evropian të Sjelljes për Integritet në Kërkimin Shkencor, që duhet të zbatohen nga institutet dhe njësitë e veçanta kërkimore-shkencore, institucionet e arsimit të lartë, institucionet kërkimore, punonjësit kërkimorë-shkencorë dhe financuesit e shkencës dhe të kërkimit shkencor.

**Neni 2**  
**Qëllimi**

Ky kod ka për qëllim të përcaktojë integritetin shkencor, parimet themelore të etikës në shkencë dhe në kërkim shkencor, normat bazë të sjelljes, praktikat e mira të shkencës dhe të kërkimit shkencor, llojet e shkeljeve e të masave disiplinore, procedurat për dhënien e tyre, në rastin e shkeljeve të etikës në shkencë dhe në kërkim shkencor, risqet dhe sistemin e menaxhimit të tyre

për institutet dhe njësitë e veçanta kërkimore-shkencore, institucionet e arsimit të lartë dhe institucionet e tjera kërkimore.

Neni 3  
**Fusha e zbatimit**

Kodi zbatohet nga të gjitha institutet dhe njësitë e veçanta kërkimore-shkencore, institucionet e arsimit të lartë, institucionet kërkimore, punonjësit kërkimorë-shkencorë dhe financuesit e shkencës dhe të kërkimit shkencor, ku kryhet veprimtari kërkimore-shkencore, duke siguruar integritet dhe transparencë në kërkimin shkencor.

KREU II  
**PARIMET THEMELORE TË ETIKËS NË SHKENCË DHE NË KËRKIM SHKENCOR**

Neni 4  
**Besueshmëria**

Ky parim siguron që cilësia e veprimtarisë kërkimore-shkencore të pasqyrojë në mënyrë të besueshme sigurimin e cilësisë në shkencë dhe në kërkim shkencor, në projektim, në metodologjinë, analizën e në përdorueshmërinë e burimeve.

Neni 5  
**Ndershmëria**

Ky parim ka qëllim garantimin e ndershmërisë në zhvillimin, realizimin, shqyrtimin, raportimin dhe komunikimin e kërkimit në një mënyrë transparente, të drejtë dhe të plotë.

Neni 6  
**Respekti**

Çdo pjesëmarrës në veprimtarinë kërkimore-shkencore ka detyrimin të respektojë kolegët, subjektet e kërkimit, shoqërinë, ekosistemet, trashëgiminë kulturore dhe mjedisin.

Neni 7  
**Përgjegjshmëria**

Parimi i përgjegjshmërisë për menaxhimin dhe organizimin e kërkimit shkencor pasqyrohet në formimin, mbikëqyrjen dhe mentorimin e kërkuesve.

Neni 8  
**Transparenca**

Punonjësi kërkimor-shkencor siguron që të dhënat, metodat dhe rezultatet e kërkimit janë të disponueshme e të qarta për të gjithë, duke zbatuar katër parimet themelore të shkencës së hapur (të gjetshme, të aksesueshme, të ndërveprueshme, të ripërdorshme), në mënyrë të drejtë dhe

transparente, duke njohur kontributet e çdo individi të përfshirë në procesin kërkimor-shkencor, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

### KREU III

#### PRAKTIKAT E MIRA TË SHKENCËS DHE TË KËRKIMIT SHKENCOR

##### Neni 9

##### **Praktikat e mira kërkimore-shkencore**

Praktikat e mira të shkencës dhe të kërkimit shkencor shërbejnë si model për institutet dhe njësitë e veçanta kërkimore-shkencore për të siguruar se rezultatet e kërkimit shkencor janë të sakta, të besueshme dhe në përputhje me standardet etike, në zbatim të kuadrit ligjor në fuqi.

##### Neni 10

##### **Hartimi dhe procesi i projektit kërkimor-shkencor**

Çdo projekt kërkimor-shkencor ndjek protokolle të qarta kërkimore, nga ku planifikohet, hartohet dhe strukturohet në mënyrë të qartë, me standarde të larta, transparence dhe dokumentimi, duke pasur parasysh objektivat, metodologjinë, marrjen e mostrës shkencore, si dhe metodat e mbledhjes e të analizës së të dhënave.

##### Neni 11

##### **Mbrojtja e të dhënave**

Të dhënat e mbledhura gjatë veprimtarisë kërkimore-shkencore ruhen në mënyrë të sigurt. Subjektet kërkimore-shkencore ndërmarrin masa teknike dhe organizative të përshtatshme për të mbrojtur të dhënat nga shkatërrime të paligjshme, humbje aksidentale, për të mbrojtur aksesin ose përhapjen nga persona të paautorizuar, veçanërisht kur përpunimi i të dhënave bëhet në rrjet, si dhe nga çdo formë tjetër e paligjshme përpunimi. Çdo veprim në sistem lidhur me aksesin, ndryshimin, korrigjimin, përhapjen e të dhënave etj., duhet të lërë gjurmë, me qëllim garantimin e sigurisë e të konfidencialitetit të të dhënave.

##### Neni 12

##### **Publikimi dhe e drejta e autorit**

Veprimtaria kërkimore-shkencore ndërtohet mbi bazën e publikimit të veprës, ndikimit dhe njohjes në një fushë të caktuar kërkimore e të subjekteve të tjera të përfshira. Njohja e kontributit të autorëve duhet të bëhet në mënyrë të drejtë, duke siguruar, që çdo individ që ka kontribuar në projektin kërkimor, të përfitojë sipas legjislacionit në fuqi për mbrojtjen e të drejtave të autorit e të të drejtave të tjera të lidhur me të. Çdo subjekti i lind e drejta për rishikimin e punës së tij kërkimore, me qëllim e vlerësimin përfundimtar të saj.

##### Neni 13

##### **Përputhshmëria me ligjin dhe etikën**

Punonjësi kërkimor-shkencor siguron se çdo kërkim shkencor të kryhet në përputhje me kuadrin rregullator në fuqi, duke respektuar etikën në kërkimin shkencor, të drejtat e personave fizikë dhe juridikë të përfshirë në kërkimin shkencor.

Neni 14

#### **Mjedisi i kërkimit shkencor**

Institucionet kërkimore-shkencore dhe institucionet e arsimit të lartë janë mjediset që nxisin ndërgjegjësimin dhe ofrojnë burime të nevojshme për sigurimin e një kulture kërkimore-shkencore, duke garantuar mjedis të respektit të ndërsjellë të barazisë e të gjithëpërfshirjes.

Neni 15

#### **Trajnimi, mbikëqyrja dhe udhëheqja**

Institucionet kërkimore-shkencore dhe institucionet e arsimit të lartë sigurojnë që kërkuesit shkencorë të marrin një formim profesional në hartimin e projektit kërkimor-shkencor, metodologjinë, analizën, shpërndarjen dhe komunikimin shkencor, duke zhvilluar programe të përshtatshme dhe eficiente të trajnimeve për pajisjen me aftësitë e nevojshme. Trajnimi, mbikëqyrja dhe udhëheqja e kërkuesit realizohet mbi bazën e modeleve të praktikave të mira shkencore.

Neni 16

#### **Menaxhimi dhe praktika e të dhënave**

Institucionet kërkimore-shkencore dhe institucionet e arsimit të lartë sigurojnë menaxhimin, ruajtjen dhe mbrojtjen, sipas legjislacionit në fuqi, të të gjitha të dhënave kërkimore e të materialeve të tjera kërkimore. Menaxhimi dhe praktika e të dhënave realizohet në zbatim të parimeve të shkencës së hapur.

Neni 17

#### **Bashkëpunimi**

Të gjitha subjektet, që kryejnë veprimtari kërkimore-shkencore, bien dakord në mënyrë formale, që të ndërtojnë marrëdhënie mbi bazën e bashkëpunimit real, etik, profesional e frytdhënës, duke respektuar integritetin kërkimor dhe pronësinë intelektuale.

Neni 18

#### **Integriteti i kërkimit shkencor në praktikë**

1. Institutet apo njësitë e veçanta kërkimore-shkencore zbatojnë standarde kombëtare dhe evropiane të integritetit në çdo fazë të procesit të kërkimit. Kjo përfshin planifikimin, realizimin dhe raportimin e kërkimeve. Proceset kërkimore-shkencore duhet të jenë të hapura e të verifikueshme, duke siguruar transparencë e besueshmëri.

2. Publikimi është një komponent kyç i kërkimit shkencor. Punonjësit kërkimorë-shkencorë dhe institutet ose njësitë e veçanta kërkimore-shkencore sigurojnë që procesi i publikimit të ndjekë parime etike, duke përfshirë transparencën në lidhje me autorësinë, financimin e çdo konflikti interesi.

3. Institutet dhe njësitë e veçanta kërkimore-shkencore, për të siguruar cilësinë dhe saktësinë e veprimtarisë kërkimore-shkencore, zhvillojnë mekanizma të vlerësimit e të verifikimit të rezultateve, sipas legjislacionit në fuqi.

#### KREU IV

### LLOJET E SHKELJEVE E TË MASAVE DISIPLINORE, SI DHE PROCEDURAT PËR DHËNIEN E TYRE NË RASTIN E SHKELJEVE TË ETIKËS NË SHKENCË DHE NË KËRKIM SHKENCOR

#### Neni 19

##### **Shkeljet e etikës në shkencë dhe në kërkim shkencor**

1. Nëse punonjësi kërkimor-shkencor, në ushtrimin e veprimtarisë së tij kërkimore-shkencore cenon integritetin dhe etikën e kërkimit shkencor, duke ndikuar në besueshmërinë e cilësinë e tij, ky cenim konsiderohet si shkelje e etikës në shkencë dhe në kërkim shkencor.

2. Për përcaktimin e masës këshilluese ose disiplinore të zbatueshme, Komiteti i Etikës bazohet në:

- a) shkaqet, rrethanat e kryerjes së shkeljes, rëndësinë dhe pasojat e ardhura prej saj;
- b) shkallën e fajësisë;
- c) ekzistencën e masave të tjera disiplinore të mëparshme.

3. Masat këshilluese ose disiplinore jepen në raport të drejtë me shkeljen e kryer.

4. Shkeljet e etikës në veprimtarinë kërkimore-shkencore janë, si më poshtë vijon:

a) Fabrikimi, i cili është manipulimi i të dhënave ose i rezultateve dhe regjistrimi a publikimi i tyre, si të vërteta;

b) Falsifikimi është manipulimi i materialeve kërkimore, pajisjeve, imazheve ose proceseve apo ndryshimi, fshirja a retushimi i të dhënave ose rezultateve pa asnjë motiv;

c) Mosraportimi i konfliktit të interesit në veprimtarinë kërkimore-shkencore, i cili është mosdeklarimi i konfliktit të interesit apo të konfliktit të mundshëm të interesit, duke ndikuar në besueshmërinë dhe në objektivitetin e kërkimit shkencor;

ç) Plagjiatura është përdorimi i punës ose ideve të dikujt tjetër, pa dhënë asnjë meritë të burimi origjinal.

5. Parimet për trajtimin e shkeljeve dhe akuzave për sjellje të papranueshme janë, si më poshtë vijon:

a) Kushdo që akuzohet për shkelje të etikës në shkencë dhe në kërkim shkencor prezumohet i pafajshëm derisa të provohet e kundërta;

b) Palët e përfshira në hetim deklarojnë çdo konflikt interesi, që mund të lindë gjatë hetimit;

c) Hetimet kryhen në mënyrë konfidenciale, me qëllim mbrojtjen e palëve në proces;

ç) Procedurat e përgjithshme për trajtimin e shkeljeve të praktikës së mirë të kërkimit shkencor janë transparente dhe garantojnë uniformitetin e tyre;

d) Personave të akuzuar për shkelje të etikës në shkencë dhe në kërkim shkencor u garantohet një proces i drejtë administrativ gjatë procesit të hetimit.

#### Neni 20

##### **Masat këshilluese**

1. Masat këshilluese propozohen nga Komiteti i Etikës dhe jepen nga titullari i institutit apo njësisë së veçantë të kërkimit shkencor.

2. Masat këshilluese konsiderohen:

- a) “Tërheqja e vëmendjes”, në rastet kur punonjësi kërkimor-shkencor nuk respekton këshillat, rekomandimet ose procedurat e strukturave eprore;
- b) “Tërheqje e vëmendjes dhe paralajmërim për dhënie mase disiplinore”, kur nuk është zbatuar propozimi për ndryshimin e metodologjisë dhe të praktikave të aplikuara përgjatë veprimtarisë kërkimore-shkencore nga punonjësit kërkimorë-shkencorë;
- c) “Paralajmërim për pezullim të veprimtarisë kërkimore-shkencore”, në rastin kur duhet të realizohet rihartimi i projektit kërkimor-shkencor, në çdo fazë, nga punonjësi kërkimor-shkencor;
- ç) “Vërejtje për shkelje të përsëritur dhe pezullim të veprimtarisë kërkimore-shkencore”, njoftimi për rishikimin dhe ridimensionimin e projektit kërkimor-shkencor nga Komiteti i Etikës.

## Neni 21

### **Shkeljet e etikës**

1. Shkeljet e etikës në shkencë dhe në kërkim shkencor të masave këshilluese kategorizohen si:

- a) shkelje të lehta, që konsiderohen:
  - i. mosrespektimi i këshillave ose i rekomandimeve të udhëheqësit shkencor;
  - ii. mosrespektimi i procedurave etike të vendosura nga strukturat eprore;
  - iii. mosrespektimi i metodologjive të kërkimit nga kërkuesit shkencorë;
  - iv. mosrespektimi i praktikave të mira të kërkimit nga kërkuesit shkencorë.
- b) shkelje të rënda, që konsiderohen:
  - i. mosrespektimi i përsëritur i këshillave ose i rekomandimeve të udhëheqësit shkencor, duke mos rihartuar projektin në çdo fazë;
  - ii. mosrespektimi i përsëritur i korrigjimit të metodologjive ose praktikave të mira, të kërkimit shkencor, duke rishikuar dhe ridimensionuar projektin kërkimor-shkencor.
- c) shkelje shumë të rënda, që konsiderohen:
  - i. mosrespektimi i çdo parimi dhe kriteri etik të këtij kodi;
  - ii. mosrespektimi i konfidencialitetit dhe i bërjes publike të materialeve konfidenciale të veprimtarisë kërkimore-shkencore.

## Neni 22

### **Shkeljet disiplinore**

1. Shkeljet në shkencë dhe në kërkim shkencor kategorizohen si:

- a) shkelje të lehta, që konsiderohen:
  - i. manipulimi i produktit autorial, të paktën në një rast;
  - ii. mosdeklarimi i drejtpërdrejtë i faktit të një konflikti interesi të drejtpërdrejtë ose të mundshëm përgjatë procesit kërkimor-shkencor;
- b) shkelje të rënda, që konsiderohen:
  - i. plagjiatura e konstatuar sipas kriterëve në legjislacionin në fuqi;
  - ii. kompromentimi i etapave të ndryshme të veprimtarisë së kërkimit shkencor;
  - iii. manipulimi i tërthortë ose i plotë i rezultateve, dokumentacioneve, metodologjive, të dhënave, që mundësojnë rezultatin e dëshiruar nga punonjësi kërkimor-shkencor;
  - iv. mosrespektimi i 1 deri në 2 parimeve dhe i standardeve themelore, në zbatim të parimit të shkencës së hapur;

v. manipulimi i 1 deri në 2 të dhënave të veprimtarisë kërkimore-shkencore, në prezantimin e një rezultati të rremë;

vi. abuzimi me burimet financiare, kur shkaktohet dëm ekonomik, deri në masën 15% të buxhetit total të projektit;

c) shkelje shumë të rënda, që konsiderohen:

i. plagjiatura e përsëritur e evidentuar, sipas kritereve në legjislacioni në fuqi;

ii. mosrespektimi i çdo kriteri dhe standardi, që mundësojnë zbatimin e parimit të shkencës së hapur në Republikën e Shqipërisë;

iii. mosrespektimi i çdo parimi të Kodit të Etikës në Shkencë dhe në Kërkim Shkencor, sipas legjislacionit në fuqi;

iv. tjetërsimi i dokumentacionit, metodologjisë, të dhënave të kërkimit-shkencor në rezultatet përfundimtare, të veprimtarisë kërkimore-shkencore, duke prezantuar një rezultat të rremë.

## Neni 23

### Masat disiplinore

1. Masat disiplinore propozohen nga Komiteti i Etikës dhe jepen nga titullari i institutit apo njësisë së veçantë të kërkimit shkencor.

2. Masat disiplinore jepen në varësi të llojeve të shkeljeve të Kodit të Etikës në Shkencë dhe në Kërkimin Shkencor dhe klasifikohen, si më poshtë vijon:

a) Shkelje të lehta janë, si vijon:

i. “Vërejtje me shkrim”, jepet për nënndarjen “i”, të shkronjës “a”, të pikës 2, të nenit 22;

ii. “Vërejtje me shkrim dhe trajnim për zbatimin e kodit të etikës në kërkimin shkencor”, jepet për nënndarjen “ii”, të shkronjës “a”, të pikës 2, të nenit 22;

iii. “Vërejtje me shkrim dhe reduktim i pagës me 30%”, jepet për nënndarjen “ii”, të shkronjës “a”, të pikës 2, të nenit 22;

b) Shkelje të rënda janë, si vijon:

i. “Reduktim i pagës nga 30% deri në 70% përgjatë zhvillimit të projektit shkencor” jepet për nënndarjen “i”, të shkronjës “b”, të pikës 2, të nenit 22;

ii. “Vërejtje me shkrim për përjashtim nga projektet kërkimore-shkencore”, jepet për nënndarjen “ii”, të shkronjës “b”, të pikës 2, të nenit 22;

iii. “Paralajmërim për ndërprerjen e kërkimit shkencor”, jepet për nënndarjet “iii”, “iv” “v” dhe “vi”, të shkronjës “b”, të pikës 2, të nenit 22;

c) Shkelje shumë të rënda janë, si vijon:

i. “Transferimi i kërkimit shkencor një kërkuesi tjetër shkencor”, jepet për nënndarjen “i”, të shkronjës “c”, të pikës 2, të nenit 22;

ii. “Revokimi, shkurtimi ose ndërprerja, rimbursimi i fondeve të kërkimit shkencor”, jepet për nënndarjen “ii”, të shkronjës “c”, të pikës 2, të nenit 22;

iii. “Përjashtimi përkohësisht për të marrë pjesë në aktivitete dhe kërkime shkencore”, jepet për nënndarjen “iii”, të shkronjës “c”, të pikës 2, të nenit 22;

iv. “Shfuqizimi i kategorisë së punonjësit të kërkimit shkencor”, jepet për nënndarjen “iv”, të shkronjës “c”, të pikës 2, të nenit 22.

3. Masat disiplinore parashkruhen sipas kalimit të këtyre afateve për:

a) shkelje të lehta, brenda 3 viteve;

b) shkelje të rënda, brenda 4 viteve;

c) shkelje shumë të rënda, brenda 5 viteve.

4. Masa disiplinore më e rëndë specifikohet në pikën 3, të nenit 32, të ligjit nr. 109/2024, ku përcaktohet se masa disiplinore më e rëndë është shfuqizimi i kategorisë së punonjësit të kërkimit shkencor, e cila jepet vetëm për shkelje të rënda të etikës së kërkimit shkencor.

5. Parimi i ligjshmërisë, proporcionalitetit dhe trajtimit të barabartë duhet të zbatohet gjatë përcaktimit të masës disiplinore, që propozohet nga Komiteti i Etikës.

6. Propozimi i dhënies së masës disiplinore përkatëse jepet në varësi të llojit, masës dhe dëmit të shkaktuar nga kryerja e shkeljes.

#### Neni 24

### **Procedurat për dhënien e masave disiplinore**

1. Instituti apo njësia e veçantë kërkimore-shkencore përcakton në rregulloren e saj të brendshme rregullat dhe procedurën, që paraqiten në lidhje me ankimimin e masave disiplinore.

2. Forma procedurale e zhvillimit të procedurës për shqyrtimin e ankimit dhe dhënien e masës organizohet sipas legjislacionit në fuqi për organizimin dhe funksionimin e institutit apo njësisë së veçantë kërkimore-shkencore.

3. Regjistrimi, hetimi dhe trajtimi i ankesave për shkelje të mundshme të integritetit në shkencë dhe në kërkim shkencor realizohet nga Komiteti i Etikës, i cili ngrihet pranë çdo institucioni kërkimor-shkencor dhe institucionit të arsimit të lartë.

4. Gjatë shqyrtimit të ankesës ruhet konfidencialiteti i ankimit.

5. Palët e përfshira në procesin e shqyrtimit të ankimit kanë të drejtë të dëgjohen, të përfaqësohen dhe të paraqesin prova.

6. Procedura fillestare e shqyrtimit të ankesës duhet të realizohet brenda 30 ditëve nga marrja e njoftimit për ankesën.

7. Dëgjesa e kërkuesit të akuzuar për shkelje të Kodit të Etikës realizohet sipas standardeve të përshtatshme të hetimit dhe kërkuesi, gjithashtu, ka të drejtën për të mos dëshmuar, nëse nuk dëshiron.

8. Procedura e shqyrtimit të ankesës duhet të realizohet sipas procedurave dhe afateve të përcaktuara në Kodin e Procedurave Administrative.

9. Në rast të parregullsive dhe të dyshimit lidhur me procedurën e ndjekur, organizata dhe/ose institucioni apo kërkuesi mund t'i drejtohen organit gjyqësor kompetent për shqyrtim të mëtejshëm.

#### Neni 25

### **Përgjegjësitë e instituteve apo njësive të veçanta të kërkimit shkencor**

1. Instituti apo njësia e veçantë kërkimore-shkencore zhvillon dhe zbaton politikat dhe rregulloret, në lidhje me integritetin në kërkimin shkencor, etikën, autorësinë, menaxhimin e të dhënave dhe konfliktin e interesit. Politikat dhe rregulloret janë të disponueshme për publikun dhe janë në përputhje me standardet kombëtare dhe praktikat më të mira ndërkombëtare.

2. Instituti apo njësia e veçantë kërkimore-shkencore mbështet nismat e shkencës së hapur, përfshirë botimin me akses të hapur dhe ndarjen e të dhënave, në përputhje me politikat evropiane të kërkimit shkencor dhe zhvillimet digjitale të Shqipërisë dhe të BE-së.

3. Integriteti është pjesë e vlerësimit institucional, rekrutimit, promovimit dhe kritereve të financimit.

4. Institutet dhe njësitë e veçanta kërkimore-shkencore janë të detyruara:

- a) të pranojnë dhe të regjistrojnë ankesa për shkelje të mundshme të integritetit në shkencë dhe në kërkim shkencor;
- b) të hetojnë këto ankesa në mënyrë të shpejtë, të ndershme dhe në përputhje me procedurën e parashikuar në legjislacionin në fuqi;
- c) të mbrojnë të drejtat e të gjitha palëve të përfshira në procedurën e hetimit administrativ;
- ç) të zbatojnë masa këshilluese apo disiplinore proporcionale, kur konstatohen shkelje.

#### Neni 26

### **Zbatimi dhe përputhshmëria**

1. Institutet dhe njësitë e veçanta kërkimore-shkencore kontribuojnë në veprimtarinë kërkimore-shkencore, duke zhvilluar sisteme për monitorimin e zbatimit të këtij kodi, duke vlerësuar përputhshmërinë e veprimtarisë së punonjësve kërkimorë-shkencorë, instituteve dhe njësite të veçanta kërkimore-shkencore me politikat e integritetit shkencor.
2. Në rastet kur shkeljet e integritetit shkencor konfirmohen, institutet ose njësitë e veçanta kërkimore-shkencore duhet të zbatojnë këtë kod dhe legjislacionin në fuqi.
3. Institutet apo njësitë e veçanta kërkimore-shkencore sigurojnë mbështetje për individët që kryejnë veprimtari kërkimore-shkencore, duke ofruar mundësi trajnimi e udhëzimi për përmirësimin e mëtejshëm të praktikave të tyre kërkimore-shkencore dhe etike.

#### Neni 27

### **Sanksionet**

Shkeljet e rregullave të parashikuara në këtë kod, kur veprimet e tyre nuk përbëjnë vepër penale, ndiqen në rrugë administrative, sipas legjislacionit në fuqi.

#### KREU V

### **RISQET DHE SISTEMI I MENAXHIMIT TË TYRE NË SHKENCË DHE NË KËRKIM SHKENCOR**

#### Neni 28

### **Risqet dhe sistemi i menaxhimit të tyre**

1. Risqet në veprimtarinë kërkimore-shkencore konsiderohen elementet, të cilat ndikojnë në vërtetësinë dhe cilësinë e punës kërkimore-shkencore dhe produktin final të kërkimit shkencor.
2. Risqet që mund të paraqiten gjatë veprimtarisë kërkimore-shkencore janë, si më poshtë vijon:
  - a) paaftësia për realizimin e rekomandimeve ose plotësimin e kërkesave të Komisionit të Etikës, në mangësi të aftësive menaxheriale profesionale;
  - b) mospërditësimi dhe mosnjohja me aktet e ndryshme, që ndërlidhen me veprimtarinë kërkimore-shkencore nga kërkuesi shkencor;
  - c) shkelja e parimeve etike e të integritetit shkencor (plagjiatura, manipulimi i të dhënave, autorësi e pasaktë);
  - ç) konflikti i interesit dhe ndikimi i papërshtatshëm në rezultatet e kërkimit shkencor, cenimi i konfidencialitetit dhe i mbrojtjes së të dhënave, rreziqeve të sigurisë laboratorike dhe në terren, rreziqet e biosigurisë dhe rreziqet mjedisore;
  - d) rreziqet që cenojnë pronësinë intelektuale dhe rrjedhja e informacionit;
  - dh) rreziqet operacionale;

e) rreziqet financiare/procedurale;

ë) rreziqet reputacionale dhe komunikimi;

f) cenimi i sistemit të menaxhimit të risqeve, duke anashkaluar identifikimin, vlerësimin, masat paraprake dhe korrigjuese, procedurat e raportimit të incidenteve e të shkeljeve, trajnimin periodik, si dhe dokumentimin dhe rishikimin periodik të risqeve gjatë të gjithë ciklit të projektit.

3. Menaxhimi i risqeve dhe procedurave përkatëse, që mund të paraqiten gjatë veprimtarisë kërkimore-shkencore, parashikohen në aktet e brendshme rregullatore të instituteve e të njësive të veçanta kërkimore-shkencore, institucionet e arsimit të lartë dhe institucionet kërkimore, sipas fushës/ave kërkimore-shkencore që ato zhvillojnë.